



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1705 Prot.

Tiranë, më 13.12.2021

**Lënda:** Sugjerime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me Projektligjin “Për paditë kolektive”.

**ZNJ. KLOTILDA BUSHKA  
KRYETARE**

**KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË  
DREJTAT E NJERIUT  
KUVENDI I SHQIPËRISË**

*Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë*

**Për dijëni:**

**ZNJ. LINDITA NIKOLLA  
KRYETARE E KUVENDIT  
KUVENDI I SHQIPËRISË**

*Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë*

**Të Nderuar!**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar<sup>1</sup>, dhe në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarur publik:

- ✓ të atributeve që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ përmbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”;

**Në vijim të ftesës Tuaj, për të dhënë mendim lidhur me projektligjin “Për Paditë Kolektive”, parashtron komentet si më poshtë vijon:**

<sup>1</sup>Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020 (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020).

*Së pari*, dëshirojmë të vëmë në vëmendjen Tuaj faktin që në datë 15.10.2020, me Ligjin Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010”, u miratuan ndryshimet ligjore në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Ndryshimet ligjore ndër të tjera, parashikuan të drejtën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion zbatues i këtij ligji, të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimi, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Konkretisht,

Neni 32 pika 1, i) parashikon:

*“Komisioneri ka kompetencë të paraqesë padi në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive”;*

Neni 34 pika 4 parashikon”:

*“Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe organizatat me interesa legjitime kanë të drejtë të paraqesin padi përpara gjykatës kompetente në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për çështje që lidhen me interesa kolektive”.*

Sa më sipër, për të qënë koherent dhe në harmoni me legjislacionin ekzistues, Ligjin “Për mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar, propozojmë si vijon:

Në nenin.53 të projektligjit “Për paditë kolektive”, në rastet e dyshimeve për diskriminim ndaj një numri të madh personash të papërcaktueshëm, këta të fundit duhet të kenë të njëjtën karakteristikë ose shkak të mbrojtur sipas nenit.1 të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ndryshuar.

Ky nen propozojmë të bëhet:

Neni 53

Padia kolektive për ndalimin e diskriminimit

Me qëllim arritjen e trajtimit të barabartë dhe parandalimit të diskriminimit, në rastet e dyshimeve për diskriminim ndaj një numri të madh personash të papërcaktueshëm, **por me të njëjtën karakteristikë ose shkak të mbrojtur sipas parashikimeve të nenit.1 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”**, nëpërmjet padisë kolektive për pushimin e cënimit mund të kërkohet ndalimi i veprimeve apo tentativës për veprime dhe mospërsëritja e tyre në të ardhmen, që sipas ligjit që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi përbëjnë diskriminim.

Në nenin 54 “Personi i legjitimuar”, të projektligjit “Për paditë kolektive”, të shtohet si person i legjitimuar edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ky nen propozojmë të bëhet:

Neni 54

Personi i legjitimuar

- *“Pavarësisht nga parashikimet e nenit 4 të këtij ligji, personi i cili ka të drejtë të ndërmarre një padi kolektive, nga ato që përmenden në nenin e mësipërm, do të jetë një organizatë jo-fitimprurëse që ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik në fushën e mbrojtjes dhe diskriminimit ose mbrojtjes e të drejtave të njeriut, si dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen nga Diskriminimi.*

*Së dyti*, lidhur me nenin 2 të Projektligjit, pika 1, germa “g”, ku është parashikuar që padia kolektive mund të ngrihet në rastet kur ekziston diskriminimi kolektiv, propozojmë që kjo pikë të riformulohet duke u sjell në përputhje edhe me parashikimet e Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Komisioneri rekomandon që neni 2, pika 1, germa “g” i Projektligjit “Për paditë kolektive”, të riformulohet si më poshtë:

- *“Shkelja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.*

*Së treti*, në nenin 5 (Shqyrtimi i padisë kolektive), parashikohet që *paditë kolektive të gjykohen në Gjykatën e vendit ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pjesa më e madhe e anëtarëve të grupit, dhe kur kjo nuk është e mundur të përcaktohet, kompetente për gjykimin e kësaj padie është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Duke qenë se në ngritjen e një padie ka një rendësi thelbësore kompetenca lëndore, tokësore e Gjykatës, në kushtet kur përcaktimi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë” kufizon të drejtën e ngritjes së padisë, propozojmë që në çdo rast shqyrtimi i padive kolektive duhet të bëhet nga Gjykata Kompetente në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Ky nen propozojmë të bëhet:

Neni 5

*Shqyrtimi i padisë kolektive*

*Shqyrtimi i padive kolektive do të bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara nga ky ligj dhe në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë për sa nuk parashikohet në këtë ligj. Paditë kolektive gjykohen në Gjykatën kompetente .*

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,*

Konc



KOMISIONERI  
*Robert Gajda*  
ROBERT GAJDA

A

